

**GJYKATA E APELIT
PRISHTINË**

NË EMËR TË POPULLIT

Numri i lëndës: **PAKR 412/15**

Data: **18 prill 2016**

Gjykata Themelore në: **Prishtinë, P.nr. 1462/14**

Originali: **në anglisht**

Gjykata e Apelit, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it në Gjykatën e Apelit, Radostin Petrov, kryetar dhe gjyqtar raportues, gjyqtari i EULEX-it në Gjykatën e Apelit, Roman Raab si dhe gjyqtari kosovar i Gjykatës së Apelit, Driton Muharremi, anëtarë të kolegjit, të asistuar nga Alan Vasak, zyrtar ligjor i EULEX-it, në cilësinë e procesmbajtësit,

Në lëndën lidhur me të pandehurin:

U.M.;

I akuzuar me Aktakuzën, PP. Nr. 1111-8/2009, të datës 4 nëntor 2010, për këto dy Pika:

Pika I.1. Marrje e ryshfetit, në kundërshtim me nenin 343, paragrafin 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK);

Pika I.2. – Nuk është objekt i kësaj procedure.

I gjykuar në shkallën e parë nga Gjykata Themelore e Prishtinës me aktgjykimin P. nr. 1462/14, të datës 26 maj 2015,

Me të cilin i pandehuri U.M. është shpallur fajtor për Pikën I.1., Marrje e ryshfetit, në kundërshtim me nenin 343, paragrafin 1 të KPK-së, për shkak se më 13 shtator 2006 në Pejë, i pandehuri në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues në shqyrtimin gjyqësor për lëndën P. nr. 474/06 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, kundër të pandehurve D.N., P.N. dhe L.K., duke qenë person zyrtar ka pranuar nga V.Z. dobi pasurore në vlerë prej 10.000 (dhjetë mijë) eurosh, para të cilat F.N. ia kishte dhënë V.Z.t për t'ia dërguar U.M.t, me qëllim që në kuadër të autorizimit të tij ta kryente një akt zyrtar të cilin nuk ishte dashur ta kryente, me premtimin e garantimit të ndërprerjes së paraburgimit ndaj të pandehurve të përmendur më lart, pas shpalljes së aktgjykimit në lëndën penale P. nr. 474/06. I pandehuri U.M. është dënuar me 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj burgim. Dobia pasurore në

vlerë prej 10.000 (dhjetë mijë) EUROSH është urdhëruar të konfiskohet brenda 30 (tridhjetë) ditësh pasi aktgjykimi të ketë marrë formën e prerë. I pandehuri është urdhëruar të paguajë shpenzimet e procedurës penale, me përjashtim të shpenzimeve të interpretimit dhe përkthimit, në vlerë prej 150 EUROSH.

Pika 1.2 e Aktakuzës është refuzuar për shkak të skadimit të afatit absolut të parashkrimit.

Duke e shqyrtuar ankesën e ushtruar nga mbrojtësi Orhan Basha, mbrojtësi Zeqir Berdynaj si dhe personalisht nga i pandehuri U.M.,

Pas marrjes parasysh të propozimit të prokurorit të apelit Lars Agren, të parashtruar më 29 shkurt 2016,

Pas mbajtjes së seancave publike të Gjykatës së Apelit më datat 16 shkurt, 24 mars si dhe më 13 prill 2016,

Pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 18 prill 2016,

Në përputhje me nenet 409, 410, 411, 415, 417, 420 dhe 426 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK),

Sjell këtë:

AKTGJYKIM

Pranohen në mënyrë të pjesshme ankesat e parashtruara nga mbrojtësi Orhan Basha, nga mbrojtësi Zeqir Berdynaj dhe personalisht nga i pandehuri U.M., kundër Aktgjykimit P. nr. 1462/14 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 26 maj 2015.

Ndryshohet Aktgjykimi P. nr. 1462/14 i Gjykatës Themelore të Prishtinës, i datës 26 maj 2015, ashtu që i pandehuri në fjalë dënohet me një (1) vit burgim, i cili nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale në kohëzgjatje prej dy (2) vjetësh.

Pjesa tjetër e aktgjykimit të kundërshtuar vërtetohet.

ARSYETIM

I. PROCEDURA E GJERTANISHME

Më 4 nëntor 2010, prokuroria ka ngritur Aktakuzën PP. Nr. 1111-8/2009 kundër të pandehurve U.M. dhe V.Z., duke e akuzuar U.M. për dy vepra penale të marrjes së ryshfetit, në kundërshtim me nenin 343, paragrafin 1 të KPK-së si dhe V.Z. për dy vepra penale – dhënie e ryshfetit dhe mashtrim.

Më 21 janar 2011, gjyqtari konfirmues ka marrë aktvendimin me të cilin aktakuza në fjalë është konfirmuar në tërësi. Aktvendimi pastaj është apeluar nga mbrojtja, por ankesa e tyre është refuzuar si e papranueshme më 22 shkurt 2011.

Pas mbajtjes së shqyrtimit të parë gjyqësor, Gjykata Themelore e Prishtinës më datën 18 janar 2012 ka sjellë aktgjykimin P.2668/11, me të cilin i pandehuri U.M. është shpallur fajtor për një vepër penale të marrjes së ryshfetit. U.M. është dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim, me dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit për dy vjet të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik. Më tej, Gjykata Themelore, duke vendosur *ex officio*, e ka ricilësuar Pikën e dytë nga Marrje e ryshfetit në Ushtrim të ndikimit (neni 345, par. 1 i KPK-së), për të cilën i pandehuri U.M. po ashtu ishte shpallur fajtor. U.M. është dënuar me një vit burgim dhe me dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit për një vit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik. Është konfiskuar shuma prej €10.000 (dhjetë mijë eurosh), si përfitim nga ryshfeti. Është caktuar dënimi unik prej tre vjetësh burgim dhe ndalimi i ushtrimit për tre vjet të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik. Po ashtu njësoj është shpallur fajtor dhe është dënuar edhe V.Z..

Aktgjykimi P.2668/11 është apeluar nga mbrojtja. Gjykata e Apelit përmes aktvendimit të saj PAKR 87/13, të sjellë më 27 mars 2014, e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe ka urdhëruar rigjykim lidhur me të dy Pikat në raport me të pandehurin U.M. Ndërkaq, akuzat ndaj të pandehurit V.Z. janë refuzuar.

Pas mbajtjes së seancave publike të rigjyimit më datat 29 shtator, 21 dhe 23 tetor, 18 dhjetor 2014, si dhe më 5 janar, 13 mars, 17 prill dhe 21 maj 2015, dhe pas mbajtjes së seancës së këshillimit dhe votimit më 21 maj 2015, më datën 26 maj 2015 Gjykata Themelore e Prishtinës në seancë publike e ka shpallur aktgjykimin e kundërshtuar.

Aktgjykimi me shkrim i është dërguar të pandehurit më 20 korrik 2015, ndërsa mbrojtësit të tij Zeqir Berdynaj më 20 korrik 2015 kurse mbrojtësit Orhan Basha më 21 korrik 2015. Ankesa është parashtruar më 31 korrik 2015.

Prokuroria nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën në fjalë.

Lënda i është kaluar Gjykatës së Apelit për vendim rreth ankesës më 27 gusht 2015.

Më 29 shkurt 2016 prokurori i apelit Lars Agren ka parashtruar propozimin e tij.

Seancat e Gjykatës së Apelit janë mbajtur më 16 shkurt, 24 mars dhe më 13 prill 2016 në praninë e të pandehurit, mbrojtësve të tij Orhan Basha dhe Zeqir Berdynaj si dhe të prokurorit të apelit të shtetit Lars Agren (më 24 mars dhe më 13 prill 2016).

Kolegji ka mbajtur këshillimin dhe votimin më 18 prill 2016.

II. OBJEKTI I ANKESAVE

Aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Themelore ka marrë formë të prerë lidhur me pikën e dytë të aktakuzës kundër U.M.t, pasi që ankesa e mbrojtjes nuk e përfshin vendimin e Gjykatës Themelore lidhur me këtë pikë, ndërsa prokuroria nuk ka parashtruar fare ankesë.

Për këtë arsye, vetëm pika e parë është e pazgjidhur në ankesën në fjalë.

III. ÇËSHTJET PRELIMINARE

A. Ligji i zbatueshëm në këtë lëndë

a. Ligji i procedurës

Më 1 janar 2013 në fuqi ka hyrë ligji i ri procedural në Kosovë – Kodi i Procedurës Penale (Ligji Nr. 04/L-123). Kodi në fjalë e ka shfuqizuar Kodin e mëparshëm të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Me nenin 545 të Kodit të tanishëm të Procedurës Penale rregullohet zbatimi apo jo i këtij kodi në varësi nga data e ngritjes së aktakuzës. Aktet të cilat kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij kodi do të jenë objekt i këtij kodi në qoftë se procedura penale hetimore apo e ndjekjes penale të atij akti ka filluar pas hyrjes në fuqi të këtij kodi. Siç është vërtetuar drejt nga Gjykata Themelore, ligji i zbatueshëm procedural prandaj do të ishte Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, pasi që shqyrtimi i parë gjyqësor për këtë lëndë ka filluar para hyrjes në fuqi të këtij kodi. Gjykata e Apelit, në përputhje me këtë, e zhvillon procedurën e saj në pajtim me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

b. Ligji material

Në përputhje me nenin 3, par. 1 të Kodit të tanishëm Penal të Republikës së Kosovës (Ligji Nr. 04/L-082), në raport me kryerësin e veprës do të zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Në rast të ndryshimit në ligjin e zbatueshëm për një lëndë të caktuar para vendimit të formës së prerë, për kryerësin do të zbatohet ligji më i favorshëm që përcaktohet me paragrafin 2 të dispozitës së përmendur më sipër. Siç është konstatuar drejt nga Gjykata Themelore, zbatimi i kodit të mëhershëm penal, pra i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës është më i favorshëm për të pandehurin sesa zbatimi i kodit të tanishëm penal. Për këtë arsye, do të zbatohet Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës.

B. Kompetenca

Në bazë të nenit 121, par. 1 të KPPP-së, kolegji e ka shqyrtuar nëse është kompetent dhe pasi që nuk është ngritur asnjë kundërshtim nga palët, kolegji mjaftohet me si vijon: në përputhje me Ligjin mbi gjykatat dhe Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë – Ligji Nr. 03/L-053, i ndryshuar me Ligjin nr.

04/L-273 dhe të sqaruar me Marrëveshjen e arritur në mes të Shefit të EULEX Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të datës 18 qershor 2014, kolegji konstaton se EULEX-i ka juridiksion mbi lëndën në fjalë dhe se kolegji është kompetent për të vendosur në lëndën përkatëse në përbërje prej një gjyqtari kosovar dhe dy gjyqtarëve të EULEX-it.

C. Pranueshmëria e ankesës

Ankesa e parashtruar nga mbrojtësi Orhan Basha, nga mbrojtësi Zeqir Berdynaj si dhe nga vetë i pandehuri U.M. është ankesën e pranueshme. Ankesa është parashtruar brenda afatit prej 15 ditësh, siç përcaktohet me nenin 398 të KPPP-së. Ankesa është ushtruar nga personat e autorizuar dhe i përmban të gjitha informatat me rëndësi sipas neneve 399 dhe 401 të KPPP-së.

D. Prokurori i EULEX-it

Mbrojtja e ka kundërshtuar caktimin e prokurorit të EULEX-it në këtë lëndë, duke pretenduar se caktimi në fjalë nuk është bërë në përputhje me ligjin. Kolegji konstaton se më 29 mars 2016, kryeprokurori i shtetit Aleksander Lumezi dhe kryeprokurori i EULEX-it Claudio Pala kanë vendosur bashkërisht t'ia caktojnë lëndën prokurorit të EULEX-it, siç edhe dokumentohet në vendimin me shkrim. Kolegji konstaton se ky vendim është në përputhje të plotë me nenet 7 dhe 7.A të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të cilat lidhen me mandatin e misionit evropian për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 04/L-273). Për këtë arsye, kundërshtimi i mbrojtjes refuzohet si i pabazuar.

IV. PARASHTRESAT E PALËVE

A. Ankesa e parashtruar nga mbrojtësi Orhan Basha, nga mbrojtësi Zeqir Berdynaj si dhe nga vetë i pandehuri U.M.

Mbrojtësit Orhan Basha dhe Zeqir Berdynaj kanë ushtruar ankesë në Gjykatën Themelore të Prishtinës në emër të të pandehurit U.M., për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Shkeljes së ligjit penale; dhe
- Vendimit mbi sanksionet penale.

Lidhur me shkeljet e dispozitave të procedurës penale, mbrojtja parashtron se Gjykata Themelore nuk i ka prezantuar qartë për çfarë arsye i konsideron disa prej fakteve të konfirmuara ndërsa disa jo si dhe kjo gjykatë po ashtu nuk i vlerësuar si duhet të gjitha provat shfajësuese. Për më tepër, Gjykata Themelore nuk i ka dhënë si duhet motivet pse i kishte refuzuar disa prej propozimeve të palëve. Për këtë arsye, arsyetimi i aktgjykimit është jo i plotë.

Përveç kësaj, aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme. Po ashtu, të pandehurit nuk i janë prezantuar të gjitha provat e siguruara gjatë hetimeve.

Kërkesa për zgjatjen e hetimeve është parashtruar pas skadimit të afatit ligjor bile edhe aktakuza është dorëzuar pas afatit. Procedura penale prandaj është dashur të përfundojë pas arritjes së afatit në fjalë.

Për më tepër, dispozitivi është i paqartë dhe konfuz si dhe në kundërtënie me arsyetimin e aktgjykimit. Po ashtu, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor nuk iu është prezantuar palëve për verifikim.

Në fund, disa prej deklaratave të dëshmitarëve janë marrë para fillimit të hetimeve, duke i bërë kështu provat në fjalë të papranueshme.

Sa i takon vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja pretendon se Gjykata Themelore në mënyrë të pasaktë e ka vërtetuar se i pandehuri ka kryer akt zyrtar të cilin nuk është dashur ta kryejë. Ndërprerja e paraburgimit, e urdhëruar nga i pandehuri ka qenë akt i drejtë dhe i ligjshëm dhe kjo gjë nuk është kontestuar as nga prokuroria. Për këtë arsye, akti i ndërprerjes së paraburgimit ka qenë akt i ligjshëm dhe i drejtë zyrtar. Për më tepër, nuk ka asnjë provë se i pandehuri ka pranuar ndonjë ryshfet për ndërprerjen e paraburgimit. Përveç kësaj, nuk përmendet askund koha specifike kur kishte ndodhur kjo marrje e ryshfetit dhe në çfarë mënyre. Deklaratat e dëshmitarëve mund të interpretohen vetëm lidhur me atë se i pandehuri nuk kishte pranuar kurrfarë të hollash. Është e qartë nga dëshmitarët kyçë se i pandehuri nuk ka qenë i përfshirë në kurrfarë marrje të ryshfetit. Të gjitha provat fajësuese janë të jokredibile. Për më tepër, restoranti Arrat nuk kishte qenë i hapur akoma kur i pandehuri supozohet se gjoja kishte qenë atje.

Sa iu përket shkeljeve të ligjit penal, mbrojtja parashtron se rrethanat të cilat përjashtojnë ndjekjen penale nuk janë vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme dhe korrekte. Veç kësaj, shuma prej 10.000 eurosh nuk mund të konfiskohet pasi që është e qartë nga deklarata e V.Z.t se i pandehuri nuk kishte pranuar kurrfarë të hollash.

Në fund, sa i takon vendimit mbi sanksionet penale, mbrojtja pretendon se Gjykata Themelore nuk i ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese.

Për më tepër, vendimi mbi konfiskimin e dobisë pasurore në vlerë prej 10.000 eurosh është një vendim i kundërligjshëm, pasi që dëshmitarja F.N. nuk kishte bërë një kërkesë të tillë dhe nuk i ishte bashkëngjitur procedurës penale kundër të pandehurit në fjalë. Në fund, shuma prej 150 eurosh për shpenzimet e procedurës penale nuk është specifikuar dhe gjithashtu nuk garantohet pasi që nuk ka pasur kurrfarë shpenzimesh.

Për të gjitha këto arsye, mbrojtja kërkon nga Gjykata e Apelit që ta ndryshojë aktgjykimin dhe ta lirojë të pandehurin.

B. Propozimi i prokurorisë së apelit

Prokurori i apelit i EULEX-it i propozon gjykatës që ta refuzojë ankesën e të pandehurit.

Aktgjykimi i apeluar nuk përmban asnjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Prokurori i apelit parashtron se provat të cilave iu referohet mbrojtja, tashmë janë vlerësuar mjaftueshëm. Hetimet janë kryer në mirëbesim. Prokurori i apelit parashtron se mbrojtja nuk ka demonstruar se të pandehurit i është bërë ndonjë paragjykim gjatë praktikës së përgatitjes së procesverbalit të seancës gjyqësore. Aktgjykimi përmban fakte dhe rrethana vendimtare me të cilat tregohet natyra kriminale e aktit të kryer, për të cilin i akuzuari është shpallur fajtor. Gjendja e vërtetuar faktike është rezultat i vlerësimit të drejtë të provave të administruara dhe ky

vërtetimi është i drejtë dhe i plotë. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore e ka zbatuar drejt ligjin penal kur ka konstatuar se veprimet e të akuzuarit i përmbajnë të gjitha elementet substanciale të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

V. GJETJET E KOLEGJIT

A. Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

a. Arsyetimi dhe kuptueshmëria

Mbrojtja pretendon se dispozitivi është i pakuptueshëm dhe në kundërtënie me veten si dhe me provat në shkresat e lëndës. Mbrojtja më tutje parashton se aktgjykimi i kundërshtuar është pamjaftueshëm i arsyetuar dhe nuk prezanton në mënyrë të qartë cilat janë arsyet pse i konsideron disa prej fakteve të konfirmuara e disa jo.

Kjo bazë ankimore refuzohet si e pabazuar.

Dispozitivi është i qartë, logjik dhe nuk është në kundërtënie me veten apo me arsyetimin. Dispozitivi ofron një përshkrim koherent dhe të kuptueshëm të fakteve vendimtare dhe i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara me nenin 396, paragrafët 3 dhe 4 të KPPP-së, në kuptim të nenit 391 të KPPP-së. Dispozitivi është plotësisht koherent me arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar si dhe i pasqyron gjetjet e shtjelluara aty. Gjykata Themelore i ka prezantuar arsyet për secilën pikë veç e veç të vendimit të saj, siç përcaktohet me nenin 396, par. 6 të KPPP-së.

Dispozitivi nëse lexohet së bashku me arsyetimin e detajuar të aktgjykimit të kundërshtuar ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të provave dhe të fakteve të cilat Gjykata Themelore i ka konsideruar të provuara dhe të paprovuara. Në përputhje me nenin 396, par. 7 të KPPP-së, Gjykata Themelore po ashtu ka bërë një vlerësim të detajuar të besueshmërisë së provave kundërtënese dhe të arsyeve të cilat e kanë çuar Gjykatën Themelore në pajtimin e pikave faktike dhe ligjore.

Është e qartë nga analiza e shtjelluar të cilën e përmban arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar se Gjykata Themelore ka kryer një analizë të kujdesshme dhe të përpiktë të provave në lëndën në fjalë. Përderisa mbrojtja mund të mos pajtohet me konkluzionet e Gjykatës Themelore pas përfundimit të analizës së provave; ky mospajtim është një kundërshtim i ndarë. Mbrojtja megjithatë nuk mund të pretendojë në mënyrë të arsyeshme se Gjykata Themelore nuk e ka përmbushur detyrën e saj për t'i shqyrtuar me kujdes dhe me përkushtim maksimal profesional provat në fjalë.

Trupi gjykues e ka mbajtur gjykimin në mënyrë të paanshme dhe i ka shqyrtuar me kujdes propozimet për prova si nga ana e mbrojtjes ashtu edhe nga ana e prokurorisë dhe me kujdes i ka peshuar provat dhe argumentet e të dyja palëve. Kjo është e qartë nga aktgjykimi i kundërshtuar dhe nga arsyetimi i dhënë nga trupi gjykues. Prapë, kolegji e përsërit se në qoftë se konkluzionet e Gjykatës Themelore lidhur me vërtetimin e fakteve kanë qenë të drejta dhe të plota apo jo, kjo është tjetër çështje e cila do të adresohet në pjesën e ardhshme të këtij aktgjykimi.

Sa iu përket çështjeve të ngritura nga mbrojtja lidhur me shkeljet e pohuara të kodit të procedurës penale gjatë fazave të ndryshme të procedurës deri në rigjykim, kolegji vëren se çështjet në fjalë tashmë janë vendosur nga ana e Gjykatës së Apelit në aktgjykimin e saj PAKR 87/13, të sjellë më 27 mars 2014. Atëherë ishte vendosur që asnjë prej këtyre kundërshtimeve nuk tregon se ka

pasur shkelje esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar apo do të mund të kishin ndikuar në sjelljen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë. Kolegji i qëndron vendimit në fjalë.

Rrjedhimisht refuzohet ankesa e mbrojtjes në këtë drejtim.

Sa i përket parashtrës së mbrojtjes se atyre nuk iu është dhënë mundësia ta shohin procesverbalin e përfunduar të shqyrtimit gjyqësor, siç përcaktohet me nenin 350, par. 2 të KPPP-së, kolegji konstaton sa vijon: pasi që EULEX-i merret me këtë lëndë, shqyrtimi gjyqësor është regjistruar në gjuhën angleze. Palët prandaj nuk kanë pasur mundësi që menjëherë ta verifikojnë procesverbalin në fjalë. Megjithatë, palëve iu është dhënë përkthimi në gjuhën shqipe i procesverbalit në fjalë në kohën e duhur. Mbrojtja atëherë e ka pasur mundësinë e dhënies së komenteve si dhe të kërkojë korrigjimet e nevojshme. Përkundër kësaj, mbrojtja nuk e ka bërë një gjë të tillë. Po ashtu, edhe ankesa e mbrojtjes nuk përmban asnjë koment apo kërkesë për korrigjim. Prandaj, shih për këtë nuk është shkelur asnjë e drejtë e të pandehurit.

Rrjedhimisht refuzohet ankesa e mbrojtjes në këtë drejtim.

B. Vërtetimi i gjendjes faktike

Mbrojtja parashtron se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të drejtë dhe si tërësi. Mbrojtja pretendon se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar drejt provat dhe prandaj ka ardhur gjer tek konkluzioni i gabuar se i pandehuri është fajtor.

Para se ta bëjë vlerësimin e çështjeve meritore të argumenteve të prezantuara nga mbrojtja lidhur me vërtetimin e gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji e përsërit edhe njëherë standardin e rishikimit lidhur me gjetjet faktike të bëra nga trupi gjykues. Është e qartë nga neni 424, par. 3 i KPPP-së se nuk mjafton që ankuesi vetëm të demonstrojë një lajthim faktik apo vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike nga ana e trupit gjykues. Në vend të kësaj, pasi që kodi i procedurës penale kërkon që vërtetimi i gabueshëm apo jo i plotë i gjendjes faktike lidhet me ‘faktin material’, ankuesi duhet gjithashtu të konstatojë se vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike vërtet lidhet me faktin material, d.m.th. është i rëndësishëm kritike për vendimin e marrë.¹ Për më tepër, është parim i përgjithshëm i procedurës së apelit që Gjykata e Apelit duhet ta marrë parasysh gjetjen faktike të trupit gjykues për shkak se pikërisht trupi gjykues është në pozitën më të mirë për t’i vlerësuar provat. Gjykata Supreme e Kosovës shpesh ka shprehur qëndrimin e saj se duhet patjetër “të respektohet vlerësimi i bërë nga trupi gjykues sa i përket besueshmërisë së dëshmitarëve të cilët janë paraqitur personalisht gjatë gjykimit dhe kanë dëshmuar para tyre. Nuk i shkon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta injorojë vlerësimin e bërë nga trupi gjykues rreth besueshmërisë së këtyre dëshmitarëve, në qoftë se nuk ka bazë të qëndrueshme për të bërë një gjë të tillë.” Standardi të cilin e ka zbatuar Gjykata Supreme ka qenë “që mos t’i ndryshojë gjetjet e gjykatës që ka gjykuar çështjen, përveç kur provat në fjalë

¹ Shih po ashtu B. Petric,; komentimi i neneve të ligjit jugosllav të procedurës penale, botimi i dytë i vitit 1986, neni 366, par. I. 3.

*në të cilat është mbështetur gjykata që e ka gjykuar çështjen nuk janë pranuar nga asnjë tribunal i arsyeshëm faktik apo kur vlerësimi i tyre ka qenë tërësisht i gabueshëm”.*²

Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar i analizon në detaje provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kolegji e ka ekzaminuar përmbledhjen e deklaratave të dëshmitarit e cila jepet në faqet 5 deri në 9 të aktgjykimit të kundërshtuar, provat materiale të cilat jepen në faqet 9 deri në 10 të aktgjykimit të kundërshtuar si dhe deklaratën e të pandehurit e cila jepet në faqet 10 deri në 11 të aktgjykimit të kundërshtuar. Për më tepër, kolegji me kujdes i ka vlerësuar analizat e tërësishme dhe të detajuara të provave, të cilat jepen në faqet 11 deri në 15. Në pikëpamjen e kolegjit, Gjykata Themelore vjen në konkluzione logjike gjatë vlerësimit të atyre provave dhe nuk gjen asnjë kundërthënie në qëndrimin e Gjykatës Themelore. Kolegji për më tepër në mënyrë autonome i ka rishikuar të gjitha provat. Pas këtij vlerësimi të kujdesshëm, kolegji është akoma plotësisht i bindur me konkluzionet dhe me arsyetimin e Gjykatës Themelore. Kolegji konstaton se ka prova të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri në fjalë është fajtor për marrje të ryshfetit, për shkak se më 13 shtator 2006 në Pejë, i pandehuri në fjalë në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Pejë, në lëndën P. nr. 474/06 kundër të pandehurve D.N., P.N. dhe L.K., në cilësinë e personit zyrtar kishte pranuar nga V.Z. dobinë pasurore në vlerë prej 10.000 (dhjetë mijë) eurosh, para këto të cilat F.N. ia kishte dhënë V.Z.t për t’ia dërguar U.M.t, në mënyrë që ai ta kryente brenda kompetencës së tij një akt zyrtar të cilin nuk duhej ta kryente, me premtimin e garantimit të ndërprerjes së paraburgimit ndaj të pandehurve të sipërpërmendur pas shpalljes së aktgjykimit në lëndën penale P. nr. 474/06. Mbrojtja nuk ka sjellë asnjë argument të ri substancial i cili nuk është adresuar tashmë nga ana e Gjykatës Themelore. Duke e parë se kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës Themelore është i arsyeshëm dhe në përputhje me ligjin, kolegji prandaj nuk e sheh të nevojshme ta përsërisë edhe një njëherë analizën e detajuar të Gjykatës Themelore. Kolegji, megjithatë, lidhur me deklaratën e dëshmitarit kyç A.N., thekson si më poshtë:

A.N. ka dëshmuar se ka qenë i interesuar në gjetjen e lidhjeve me qëllim të sigurimit të lirit të vëllezërve të tij nga burgu. Përmes V.Z.t, A.N. ka ardhur në kontakt me të pandehurin në fjalë. A.N. është takuar me të pandehurit (së bashku me V.Z.n) në një restorant dhe i është dhënë garanci nga i pandehuri se lënda e vëllezërve të tij do të zgjidhet si duhet nga i pandehuri. Si kompensim për këtë, A.N. duhet t’ia dërgonte të pandehurit përmes V.Z.t një zarf me të holla dhe një telefon Noka. Ashtu sikur edhe Gjykata Themelore, kolegji konstaton se kjo dëshmi e dëshmitarit A.N. është kredibile dhe e besueshme. Dëshmia e A.N.t mbështetet edhe me deklaratat e dhëna gjatë procedurës paraprake nga F.N. dhe nga P.G.. Kolegji plotësisht e miraton arsyetimin e detajuar të Gjykatës Themelore lidhur me atë se pse dëshmitë fajësuese (inkriminuese) konsiderohen kredibile dhe të besueshme, në veçanti pjesa në vazhdim:

“Sa iu përket deklaratave të dëshmitarëve të dhëna në këtë rigjykim, trupi gjykues ka konstatuar se deklarata e A.N., e dhënë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më datën 05.01.2015 është deklarata më e besueshme, për shkak se ajo përputhet me deklaratën e tij të parë të dhënë në polici më datën 15.01.2009. Mënyra si i sjell ndër mend faktet ai,

² Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, par. 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, par. 30.

është logjike ndërsa arsyeja pse nuk i kujtohen disa detaje justifikohet me faktin se ka kaluar një kohë goxha e gjatë. Për më tepër, kur të konfirmohen me këto detaje, p.sh. shumica e parave, ai e kishte konfirmuar se e ëma e tij, F.N., një ditë para vëllezërit e tij ishin liruar nga paraburgimi, e kishte thirrur në telefon dhe e kishte informuar se së bashku me P.G.n dhe me V.Z.n do të shkonte tek U.M. për t'i dorëzuar paratë. Për më tepër, dëshmitari A.N. po ashtu e ka konfirmuar se ishte informuar nga F.N. menjëherë pas kthimit në shtëpi se V.Z. ia kishte dorëzuar paratë U.M.t. Si konkluzion, A.N. e ka konfirmuar se F.N. ia kishte dhënë 10.000 euro V.Z.t për t'ia dërguar U.M.t, një ditë para se vëllezërit e tij ishin liruar nga paraburgimi.”

Kolegji e përsërit se e miraton në tërësi edhe arsyetimin e detajuar të Gjykatës Themelore lidhur me atë se pse deklaratat e tjera konsiderohen të pabesueshme, siç shtjellohet në mënyrë të mjaftueshme nga Gjykata Themelore në faqet 13 dhe 14 të aktgjykimit të kundërshtuar.

Në konkluzion, kolegji është i bindur se Gjykata Themelore në mënyrë të plotë dhe të saktë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se argumentet e ngritura në ankesa nuk i zbehin gjetjet në fjalë. Për këtë arsye, kjo bazë ankimore e mbrojtjes refuzohet si e pabazuar.

C. Vendimi mbi sanksionin penal

Mbrojtja e kundërshton caktimin e dënimeve, duke e konsideruar atë si të padrejtë dhe si të kundërligjshëm.

Në bazë të nenit 391 të KPPP-së, gjykata e shqipton dënimin nëse i pandehuri shpallet fajtor. Duke e parë se Gjykata Themelore me të drejtë e ka shpallur fajtor të pandehurin, atëherë shqiptimi i dënimit është bërë në mënyrë të ligjshme.

Në bazë të nenit 396, par. 8 të KPPP-së, gjykata i merr parasysh të gjithë faktorët me rëndësi të nevojshëm për caktimin e dënimit adekuat. Gjykata Themelore i ka vlerësuar gabimisht rrethanat lehtësuese. Motivi i vetëm për kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit, siç është ngritur me të drejtë nga prokurori i apelit, ka qenë përfitimi i dobisë pasurore. Prandaj, përfitimi i dobisë pasurore, si një prej elementeve të veprës penale, nuk mund të jetë faktor rëndues. Gjykata Themelore po ashtu nuk e ka marrë parasysh rrethanën lehtësuese se vepra penale në fjalë ka ndodhur para një kohe relativisht të gjatë, përkatësisht në vitin 2006. Për shkak të kësaj, kolegji e miraton pjesërisht ankesën e mbrojtjes dhe e ndryshon aktgjykimin e kundërshtuar duke shqiptuar dënim më të butë. Pas vlerësimit dhe peshimit të rrethanave lehtësuese dhe atyre rënduese, kolegji konstaton se burgimi në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili nuk do të ekzekutohet po qe se i pandehuri nuk kryen tjetër vepër penale brenda periudhës prej dy (2) vjetësh, është dënim adekuat dhe proporcional.

D. Konfiskimi

Sikur Gjykata Themelore, edhe kolegji konsideron se në bazë të nenit 343, par. 4 të KPK-së, është i detyrueshëm konfiskimi i dobisë pasurore. Në këtë drejtim, nuk është me rëndësi nëse dëshmitarja F.N. i është bashkuar apo jo ndjekjes penale. Lidhur me shumë që duhet të konfiskohet, kolegji i referohet gjendjes faktike të vërtetuar drejt nga Gjykata Themelore se bëhet fjalë për shumën prej 10.000 eurosh e cila është vërtetuar se i është dorëzuar të pandehurit. Për këtë arsye, kjo bazë ankimore e mbrojtjes refuzohet si e pabazuar..

E. Shpenzimet

Mbrojtja parashtrohet se shuma në vlerën prej 150 eurosh në emër të shpenzimeve të procedurës penale nuk është specifikuar dhe po ashtu as nuk vërtetohet që shpenzimet në fjalë janë bërë.

Kolegji e refuzon këtë bazë ankimore, për shkak se paushalli prej 150 eurosh nuk është përcaktuar në dëm të të pandehurit. Seancat publike dëgjimore të rigjykimit janë mbajtur më 29 shtator, më 21 dhe 23 tetor, më 18 dhjetor 2014 si dhe më 5 janar, më 13 mars, më 17 prill dhe më 21 maj 2015. Shpenzimet për procedurat në fjalë kanë qenë shumë më të mëdha sesa shuma prej vetëm 150 eurosh. I pandehuri është fajtor dhe për këtë arsye, ai obligohet t'i rimbursojë shpenzimet e procedurës.

F. Vërejtjet përfundimtare

Gjykata e Apelit – për arsyet e shtjelluara si më lart – në mënyrë të pjesshme e pranon ankesën e mbrojtjes lidhur me shqiptimin e një mase më të lehtë, ndërsa e vërteton pjesën tjetër të aktgjykimit të kundërshtuar.

Bashkëngjitur me këtë aktgjykim është edhe mendimi mospajtues i gjyqtarit Driton Muharremi.

Aktgjykimi i arsyetuar me shkrim është përfunduar më datën 18 maj 2016.

Kryetari i kolegjit,

Radostin Petrov

faqe 11 nga 12

Gjyqtar i EULEX-it

Anëtari i kolegjit,

Driton Muharremi
Gjyqtar kosovar

Anëtari i kolegjit,

Roman Raab
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës,

Alan Vasak
Zyrtar ligjor i EULEX-it

Gjykata e Apelit
Prishtinë

PAKR 412/15

18 prill 2015